



148

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 10757

Nr. koleksioni: 4538

Tirane më 01/12/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2023053950505312803



“Taksa e Pullës u Likuidua”



KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, me date 01 11 2023 (dy mijë e njëzet e tre), në zyrën noteriale të Noter Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, në adresën Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, K. I, Tiranë, përpara meje Zëvendësnoteres Elsa Gurra, e autorizuar rregullisht nga Noteri për redaktimin e akteve dhe veprimeve noteriale gjatë mungesës së tij, u paraqitën dhe kërkuan redaktimin Kontrate Shitje Kuote palët e mëposhtme:

SHITES:

Manjola Hysenaj, atësia Mehmet, amësia Fatmira, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në ELBASAN, me adresë Nustret Kokobobo 00910401; Nd. 6; H. 1; Elbasan; Elbasan; 3001; Elbasan, lindur më 24/02/1985, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034230791 dhe nr. personal I55224042K,

(*ne vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Shitësi”*)

Dhe

BLERES:

Gentian Parruca, atësia Bardhyl, amësia Jolanda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Eduard Mano 03910036; Nd. 8; H. 15; Ap. 3; Farkë; Selitë; 1044; Tiranë, lindur më 05/07/1978, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038096790 dhe nr. personal H80705059H,

(*ne vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “Blerësi”*)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Zëvendësnoteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “ERGI” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate, do të referohen individualisht si “Pale/a” dhe se bashku si “Pale/et”.

MEQENESE:

- A.** Shitësi është ortak zotërues i 25% (njetete përqind) të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “ERGI” shpk. (ne vijim “**Shoqëria**”), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e qe funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS K72522812K dhe me seli në Golem, Qerret, rruga “Besa”, zona kadastrale nr. 3101, pasuria nr. 14/35, kapitali themeltar i regjistruar i të cilës është në



A2023053950505312803

shumën ALL 300.000 (treqind mijë Lekë), sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

- B.** Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit të gjithë kuotën prej 25% (njëzet e pesë përqind) që Shitësi zotëron në kapitalin e Shoqërisë (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "**Kuota**") dhe Blerësi dëshiron të blejë Kuotën e kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi.
- C.** Kalimi i Kuotës sipas kësaj Kontrate është miratuar me vendimin bashkëlidhur të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- D.** Nga verifikimi i Regjistrimit të Barreve Siguresë, Kuota rezulton të jete e lire dhe e pa barrësuar.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për të lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

NENI 1 OBJEKTI

- 1.1.** Nëpërmjet kësaj kontrate Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi kundrejt çmimit të shitjes dhe sipas kushteve të caktuara të gjithë Kuotën e kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi dhe që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ergi" shpk.

NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1.** Çmimi i shitjes së Kuotës që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë është LEK 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë lekë), i njëjtë me vlerën nominale të kontributit të shitësit në kapitalin e shoqërisë. Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm. Çmimi i shitjes i është paguar shitësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palët nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me këtë.

NENI 3 KALIMI I PRONESISE MBI KUOTEN

- 3.1.** Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Shitësi të Blerësit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas ligjit.
- 3.2.** Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, me lidhjen e kësaj Kontrate, do të jete si vijon:
- z. Gentian Daja mbetet zotëruar i 1 kuote që përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit;
 - z. Gentian Parruca behet zotëruar i 1 kuote që përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit



NENI 4
DEKLARATA DHE GARANCI

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

- a. Shoqëria ekziston në mënyrë të ligjshme dhe kryen veprimtarinë tregtare sipas objektit të saj të deklaruar.
- b. Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotës dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
- c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirisht e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
- d. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, të drejta parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë të drejtë reale apo garancie mbi Kuotën.
- e. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
- f. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a. Blerësi ka tagra të plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
- b. Blerësi deklaron e garanton se e njeh gjendjen financiare dhe kontabël të Shoqërisë dhe se dëshiron të fitojë pronësinë mbi Kuotën pa rezerva të asnjë lloji.
- c. Blerësi do të paguajë çmimin e shitjes sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
- d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
- e. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

Neni 5
DISPOZITA TE FUNDIT

- 5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
- 5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.3. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.



- 5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen kopje të dokumenteve të identifikimit të Palëve dhe Aneksi A (Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë) dhe Aneksi B (Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë për miratimin e transferimit të pjesëve të kapitalit).

Kontrata u redaktua nga unë Zëvendësnoteri sipas kërkesës së palëve në gjuhën shqipe dhe në 4 kopje origjinale, dhe pasi u lexua dhe u shpjegua palëve nga unë Zëvendësnoteri me zë të lartë dhe të qartë u kuptua dhe u pranua prej palëve, u nënshkrua rregullisht dhe pa vërejtje prej palëve në praninë time dhe unë, Zëvendësnoteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë efektet e tij dhe e nënshkruaj rregullisht sipas autorizimit të Noterit Julian Zhelegu.

SHITËSI

Manjola Hysenaj

BLERËSIT

Gentian Parruca

NOTER

JULIAN ZHELEGU

Perfaqësuar me autorizim nga

Zëvendësnoteri

Elsa Gurra





Julian ZHELEGU
STUDIO NOTERIALE
Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13
Tiranë, Shqipëri.
NIPT: K61717003K

Tel & Fax: + 355 4 22 555 28 Mobil: + 355 68 20 27 818 E-mail: noteri@studiozhelegu.net

Nr. 2 Prot.

Tiranë, më 24.11.2023

AUTORIZIM

Bazuar ne nenin 66/3 te Ligjit 110/2018 "Për Noterinë" dhe duke qene se nuk do të ndodhem në Republikën e Shqipërisë prej datës 24.11.2023 (njezete e kater nentor dy mijë e njëzet e tre) deri më datë 8.12.2023 (tetë dhjetor dy mijë e njëzet e tre), autorizoj Zëvendësnoteren znj. Elsa GURRA, për te kryer shërbimet noteriale kundrejt palëve të treta, duke nënshkruar aktet noteriale dhe veprimet e tjera noteriale. Zëvendësnoterja autorizohet të redaktojë dhe nënshkruajë sipas ligjit aktet dhe veprimet noteriale, pa kufizim të kompetencave.

Afati i ushtrimit të veprimtarisë së zëvendësnoteres Elsa GURRA fillon më 24.11.2023 (njezete e kater nentor dy mijë e njëzet e tre) dhe mbaron datë 8.12.2023 (tetë dhjetor dy mijë e njëzet e tre)

NOTERI
Julian ZHELEGU



Subjekti: "ERGI" SHPK

NIPT: K72522812K

Adresa: Tirane Golem QERET Rruga "Besa", zona kadastrale nr.3101, pasuria nr.14/35

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
"ERGI" Sh.p.k

Sot më datë 30.11.2023, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "ERGI" Shpk, me NUIS K72522812K dhe me seli në Golem, Qerret, Rruga "Besa", zona kadastralenr.3101, pasuria nr.14/35, kapitali themeltar i regjistruar i së cilës është në shumën ALL 300,000 (treqind mijë Lekë), pasi shqyrtoi çështjet e mëposhtme të rendit të ditës:

- 1- Miratimi i shitjes së kuotës së zotëruar nga ortakja Znj. Manjola Hysenaj në favor të blerësit Z. Gentian Parruca.
- 2- Të tjera.

Në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 9901/2008, të ndryshuar, unanimisht,

VENDOSI:

- 1- Të miratojë transferimin nëpërmjet shitjes së kuotës e cila përfaqëson 25% të kapitalit që zotëron ortakja Znj. Manjola Hysenaj në favor të Z.Gentian Parruca, i cili së bashku me kuotën e vet prej 25 % të kapitalit arrin në zotërimin e një kuote prej 50 % të kapitalit.
- 2- Të autorizojë lidhjen e kontratës/marrëveshjes përkatëse pa kufizim kohor dhe sipas kushteve e afateve të miratuara nga palët.

Ky Vendim u miratua dhe u nënshkrua rregullisht nga ortakët e Shoqërisë si më poshtë vijon:

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Gentian DAJA

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Gentian PARRUCA

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Manjola HYSENAJ

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K72522812K	
2. Data e Regjistrimit	16/01/2007	
3. Emri i Subjektit	"ERGI" SHPK	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	06/10/2006	
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/10/2006	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Golem QERET Rruga "Besa", zona kadastrale nr.3101, pasuria nr.14/35	
8. Kapitali	300.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndërtimin, investimin, rikonstruksionin e godinave civile, industriale, turistike, bujqesore, ujesjellesa kanaJlzyme, rrugeve, veprave të ndryshme të artit në fushën e ndërtimit etj. Import eksport e tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm industriale të përdorimit të gjere, konfeksione tekstile, paisje elektroshtepiake, hidrosanitare, materiale ndërtimi, artikuj mobilerie, kancelarie, pllake për shtrim e veshje, punime duralumini e punim pllaka gipsi. Shërbime hotelierie dhe shërbime turistike të të gjitha llojeve përfshirë organizim ekskursionesh si dhe çdo veprimtari tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar. Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese hotelieri, bar restorant, me plan shërbim të personalizuar dhe plan shërbim " çdo gjë e përfshirë" (all inclusive), shazllone, stacione plazhi, zhvillim i panairëve, seminarëve dhe work _ shopeve, shërbime opsionale plotësuese me karakter çlodhje, pushimi, apo defrimi, spektakli, lojra, organizime dhe realizime "eventesh" e ndryshme, herim parkimi, si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit të shoqërisë, si dhe tregti importi produkte alkoli "vere".	
10. Administratori/ët	Astrit Daja	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 24/04/2023	Deri: 23/04/2028

11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore: 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	GentianParruca	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 75.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	GentianDaja	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 150.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Ortakët	ManjolaHysenaj	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 75.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Golem QERET Rruga "Besa", "Bellavista" objekt 1-katesh, zona kadastrale nr.3101, pasuria nr.14/259+1-N1 Tirane Golem QERET Rruga "Besa", "Supreme Hotel & SPA" objekt 5+1, zona kadastrale nr.3101, pasuria nr.14/35	
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: "ERGI" SHPK E-Mail: Kontabel4e@outlook.com Telefon: 0674934801 Të Tjera: Drejtor teknik i shoqërisë emërohet z. Safet Saraçi	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 30/11/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)